

VENDIM
Nr. 60/2020

**PËR EMËRIMIN E ZONJËS MIMOZA KAÇI NË DETYRËN E ANËTARIT TË
BORDIT TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE, QË DO TË
MBAJË FUNKSIONIN E NËNDREJTORIT EKZEKUTIV TË KËTIJ
INSTITUCIONI**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 5 dhe 6, të ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, të ndryshuar, si dhe të nenit 111, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit për Ekonominë dhe Financat,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Emërimin e zonjës Mimoza Kaçi në detyrën e anëtarit të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, që do të mbajë funksionin e Nëndrejtorit Ekzekutiv të këtij institucioni me një mandat 5-vjeçar.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 7.10.2020